

SHTYPI BULLGAR MBI KRYENGRITJEN E PËRGJITHSHME SHQIPTARE TË VITIT 1912

Ramiz Abdyl

Instituti i Historisë së Kosovës
Prishtinë

KUD 949.65:930.22

Punim studimor

Marrë për botim më 5 mars 1996

P e r m b a j t j a e s h k u r t ë r : Si rezultat i veprimtarisë së pandërprerë dhe aktivitetit të ngjeshur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në organizimin e sukseshëm të popullit shqiptar ishte lufta për të dalë përfundimisht nga zgjedhja osmane në një anë, dhe në anën tjetër ishte interesimi i madh i politikës bullgare dhe diplomacia e saj për fatin e provincave të Turqisë evropiane. Për të shkëputur në çastin e volitshëm sa më shumë pjesë prej tyre si dhe për faktin se jo larg kufirit bullgar zhvilloheshin përleshje të përgjakshme midis kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë turke, ishin shkaqet që opinioni bullgar të njihet me anë të shtypit mbi kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912.

Se shtypi bullgar i kushtoi vëmendje të madhe kësaj kryengritjeje flet fakti që rrallë qëllonte që në shtyllat e mbi dhjetë gazetave të përditshme dhe dhjetëra të tjera të përkohshme të Sofjes të mos shkruajnë mbi rrjedhat e saj, apo mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Kësodore, që nga fillimi deri në përfundimin e saj u shkruan qindra informacione, lajme, komente e artikuj analitikë. Shumica e tyre nga vetë pena e gazetarëve e korrespondentëve bullgarë nga Shkupi e Selaniku, e herë-herë edhe nga brenditë më të thella të trojeve shqiptare. Mjaftë nga këta artikuj zinin vend edhe në faqet e para si artikuj redaksional ose kryeartikuj¹.

¹ Punimi është rezultat i kërkimeve në bibliotekat e Sofjes gjatë tetorit të vitit 1992, ku kam hasur në mirëkuptim për shfrytëzimin dhe kseroksimin e shtypit bullgar. Shfrytëzoj rastin të falëndëroj sidomos punëtorët e Bibliotekës Universitare dhe të Akademisë së Shkencave. Shtypi bullgar i kësaj kohe bënte llogaritjen e kohës sipas kalendarit Gregorian, që dallon nga ky i sotmi për 13 ditë.

Pjesa dërmuese e këtij shtypi që ishte nën ndikimin e politikës zyrtare që pretendonte Bullgarinë e Shën Stefanit, duke përfshirë këtu edhe vise shqiptare në lindje të Liqenit të Ohrit, kishte qëndrim të dyfishtë ndaj çështjes shqiptare. Derisa në një anë për trojet shqiptare në lindje të vijës Liqeni i Ohrit, Lumi Drin, Mali Sharr dhe masivi i Karadakut, flitej gjithnjë si për vise bullgare, ndërkaq për viset në perëndim të kësaj vije flitej drejtë si për viset e Shqipërisë, të banuara nga shqiptarët, pasardhësit e ilirëve. Madje, edhe "(...) *bërthama më e madhe e Perandorisë së Lashtë maqedone*" përbëhej prej tyre².

Në kuadër të objektivave të përmendura më sipër të politikës bullgare mbi Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912 deri në çlirimin e Shkupit dhe të trojeve tjera shqiptare të Maqedonisë së sotme shkruhej mjaft objektivisht, jepej kuadër i plotë dhe i drejtë i saj, herë-herë nuk fshehej simpatia ndaj kryengritësve. Ndërkaq, zgjerimi i kryengritjes edhe në trojet e pretenduara shqiptare, dhe në veçanti pas çlirimit të tyre nga forcat kryengritëse shqiptare, ndryshoi brenda ditës qëndrimi i këtij shtypi, i cili filloi të përshkohet nga subjektivizmi, njëanshmëria dhe tendencat denigruese e përbuzëse deri në shkallën e shovinizmit të papërmbajtur bullgaromadh.

Pjesa dërmuese e shtypit bullgar deri në periudhën e përmendur më sipër, rrjedhimisht kur flitej për viset jashtë viseve të pretenduara bullgare ajo vlerësohet gjithnjë drejt si *Lëvizje, Revolucion, Lëvizje e Përgjithshme Popullore*, madje si më e fuqishmja në Turqinë evropiane etj.

Lexuesi bullgar shkaqet e fillimit të Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare i gjen te mospërmëshja e premtimeve të dhëna shqiptarëve nga xhonturqit. Në një artikull të gjatë të gazetës "Nardona prava", shqiptarët cilësoheshin si "(...) *heronjtë e Revolucionit* (xhonturk nën. i R.A.) *sot janë zhgënjyer (...) reformat e premtuara ishin një farsë boshe* (...) "³, sepse pasoi "mbyllja e shkollave me alfabet latin",⁴ thuhej në një artikull të gazetës Makedonija. Ndërkaq, në një artikull të gazetës Bullgarija thuhej se "*kërkesat e drejta të shqiptarëve u mbytën me gjak nga ekspeditat barbare të Xhavit Pashës dhe Shefqet Turgut Pashës*"⁵. Shkaqet e kryengritjes jepën më së miri në artikullin e gazetës Makedonija "Albancite vstavaat (shqiptarët ngriten) "(...) *të shtypur nga robëria turke shqiptarët dhanë besë të re që të ngriten kundër regjimit të turqëve të rinj. Ky komb trim ka vendosur t'i këpusë prangat e robërisë së një qeverie të mbuluar me gjak...*"⁶.

² *Botovo diplomatska*, Vardar, Sofia, 17.IV.1912, f.2.

³ Mladoturksa misija v Sofija, "Nardoni prava", nr.55, 7.III.1912.

⁴ Mizerijata v Albanija, "Makedonija" nr.552, 29.IV.1912, f.4.

⁵ Makedonija nr.522, 29.IV.1912/4

⁶ Blgarija nr.120, 29.06.1912.

Lajmet e para mbi përpjekjet e armatosura midis çetave kryengritëse shqiptare dhe njësiteve të rregullta të ushtrisë dhe xhandarmërisë osmane fillojnë të jepen nga mesi i prillit 1912. Si vatrë e luftimeve të përgjakshme është Malësia e Gjakovës, kurse nga gjysma e parë e majit lexuesi informohet se zjarri i kryengritjes është përhapur edhe në anën e Pejës, Istogur, të Lumës, të Mirditës dhe të Zadrimës. Ndërkaq, gjatë gjysmës së dytë të këtij muaji bëhet e ditur se kryengritja kishte përfshirë gjithë Vilajetin e Kosovës, dhe më pas atë të Shkodrës, respektivisht Shqipërinë e sotme Veriore⁷, siç emërtoheshin me të drejtë në faqet e këtij shtypi këto dy njësi administrative të banuara kryesisht nga shqiptarët.

Në artikujtë e shumtë të shtypit bullgar jepen të dhëna me interes mbi përleshjet e njëpasnjëshme midis forcave të armatosura të ushtrisë dhe xhandarmërisë turke, me artilerinë e rëndë që shndërronin në gërmadha fshatra të tëra shqiptare. Në anën tjetër forcat kryengritëse të armatosura shumë dobët, fillimisht vetëm me pushkë, por që ia delnin të siguronin epërsi krahas njohjes së mirë të terrenit, dhe kështu korrnin fitore në sajë të moralit të lartë luftarak dhe vendosmërinë për t'u sakrifikuar për lirinë e Atdheut. Një nga shembujt karakteristik të gatishmërisë së qëndresës heroike të luftarëve shqiptar mund të shërbejë një artikull i gazetës "Narodni prava", në të cilin flitet gjerësisht mbi betejën e Çabratit, atëbotë fshat afër Gjakovës, ku thuhet se pati shumë të vrarë nga të dy palët. Spikatë me heroizëm luftëtari 60 vjeçar Aziz Seferi, i cili sipas shembullit të Mic Sokolit, kishte vendosur që me trupin e tij ta asgjësonte topin që po bënte kërde në pozicionet e forcave shqiptare. Dhe në çastin kur sapo e kapte grykën e tij, gjylet që shpërthyen në atë çast ia hodhën dy duar në ajër. U kap i gjallë dhe u pushkatua⁸.

Nga shumë artikuj të këtij shtypi del kuadri i përleshjeve të përgjakshme midis forcave të ushtrisë e xhandarmërisë turke dhe forcave kryengritëse shqiptare, duke pasqyruar humbjet e mëdha nga të dy palët, sidomos të forcave armike. Po i veçojmë disa shembuj. Sipas gazetës "Preporec" bëhet e ditur se efektivat e forcave turke që ishin nisur prej Gjakovës për në Pejë ishin sulmuar afër Junikut nga kryengritësit shqiptarë. Me atë rast ishin vrarë 50 ushtarë turq dhe shumë të tjerë ishin plagosur.⁹ Ndërkaq, sipas gazetës "Narodni prava" nga përleshjet që u zhvilluan në maj të vitit 1912 në trevën e Pejës, Gjakovës dhe Mitrovicës kishte 200 të vrarë nga të dy palët, kurse vetëm gjatë javës së fundit të këtij muaji forcat turke kishin humbur në Vilajetin e Kosovës 400 ushtarë.¹⁰ Pas përleshjes që u zhvillua midis kryengritësve dhe njësiteve të ushtrisë turke, afër Lezhës, kjo e fundit pati 30

⁷ *Anarhija v Albanija*, Preporec, 24.IV.1912.

⁸ *Revolucija v Albanija*, Narodni Prava, 10.V.1913,3.

⁹ Preporec, 26.5.1912,3.

¹⁰ *Revolucija v Albanija*, Narodni Prava, 29.5.1912,2.

ushatarë të vrarë.¹¹ Në luftimet disaditëshe që u zhvilluan në rajonin e Hasit humbjet e ushtrisë turke ishin mbi 300 të vrarë e të plagosur.¹² Nga një përlëshje që u zhvillua në kufirin midis Vilajetit të Shkodrës dhe të Kosovës, kryengritësit kishin zënë robër 200 ushtarë turq.¹³ Në përlëshjen që u zhvilluan midis kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë turke, kjo e fundit kishte pas humbje të mëdha, me ç'rast ishin çarmatosur 520 ushtarë dhe 80 xhandarë.¹⁴ Çeta e Sali Mehmet Çaushtit kishte vrarë mydyrin e Hogoshtit¹⁵, kurse Kajmekani i Gjilanit është vrarë nga dora e ushtarit shqiptar¹⁶ etj.

Tabllonë e përlëshjeve të pandërprera midis forcave kryengritse dhe njësiteve të ushtrisë dhe xhandarmërisë turke e plotësojnë edhe informacionet mbi të plagosurit, nga të cilët ishin mbushur përplotë spitalet i Prishtinës dhe të Shkupit. Meqenëse nuk kishte më vend në spitale, të plagosurit, nga radhët e ushtrisë turke ishin vendosur nëpër hane e shtëpi private të këtyre qyteteve.¹⁷

Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare Antiosmane në pjesën dërmuese të shtypit qëndror bullgar vlerësohet si shumë serioze, me një karakter të thellë revolucionar edhe për faktin se në krye të saj ishin vënë ish deputetët e Parlamentit osman si dhe udhëheqës të tjerë të shquar popullor si Hasan be Prishtina, Isa Boletini, Ismail Qemali, Riza be Gjakova, Bajram Curri, Idriz Seferi, Mehmet pashë Deralla, Basri be Dibra, Jahja Efendiu, Dervish Hima, Nexhp Draga etj.¹⁸ Ndërsa, si udhëheqës të shquar krahinor përmenden: në Dukagjin Zeqir Halili, Zefi i Vogël, Sali Gjuka dhe Bajram Dakiani¹⁹, në anën e Llapit Shaban Tahiri²⁰, në anën e Pollogut Aziz Rebeli²¹, në trevën e Vushtrisë Ahmet Prekazi e Zejnullah Vuçiterni, në trevën e Prishtinës Xhemajl Prishtina²², në Anamoravë Mehmet Çaushtit dhe Sali Aga, në anën e Bujanocit, Preshevës dhe Kumanovës Sheh Strima, Dan Miratoca, Kadri Hasani dhe Dan Çarri²³, në Shqipërinë e Mesme Dedë Koka dhe Abdi bej Toptani, nga Shqipëria e sotme Veriore Mon beu, nga Mirdita Gjon Marka Gjoni, nga ana e Prizrenit dhe Lumës Ramadan Zaskoku, Islam Spahiu, Sheh

¹¹ *Voenitot bunt v Albanija*, Utro, 30.5.1912,3.

¹² *Vstania v Albanija*, Blgarija, 1.6.1912,3.

¹³ *Dviženiete v Albanija*, Utro, 3.6.1912,3.

¹⁴ *Vojnite sudiri v Albanija*, Preporec, 5.6.1912.

¹⁵ Preporec, 15.6.1912,3.

¹⁶ *Vojnata v Turcija*, 2.7.1912,3.

¹⁷ *Vstanie v Albanija*, Utro, 3.7.1912,1; Telegrami; Utro, 28.6.1912,2.

¹⁸ Preporec, 8.5.1912 1-2; Po kjo gazetë 12.7.1912,2; Dnevnik, 10.07.1912; Družba, 28.V.1912.

¹⁹ Preporec, 26.V.1912,3

²⁰ *Po aty*, 14.V.1912.

²¹ Utro, 25.VI.1912.

²² Dnevnik, 25.6.1912,3,

²³ Preporec, 27.7.1912.

Musa Zade, nga Shkupi Menduh beu dhe Jashar beu, nga Shqipëria Jugore Avni dhe Kasëm beu²⁴ etj.

Gjatë muajit qershor 1912 lajmet e shtypit bullgar bëjnë të ditur se kryengritja kishte përfshirë të gjitha viset etnike të Shqipërisë rrjedhimisht edhe dy vilajetet tjera të banuara kryesisht me shqiptarë, Vilajetin e Manastirit dhe atë të Janinës, ku shquhen si organizatorë Dervish Hima dhe Themistokli Gërmenji²⁵. Kësodore tashmë kryengritja kishte marrë karakter gjithëkombëtar. Ky karakter më së miri del nga një intervistë e gazetarit bullgar që e zhvillon me njërin nga udhëheqësit e çetave kryengritëse të Shqipërisë së Mesme Dedë Kokën, ku ndër të tjera thuhet: "(...) ky trim plak 60 vjeçar që nuk di shkrim lexim, kur e pyeta pse shqiptarët vazhdojnë të luftojnë, ai m'u përgjeggj: kur pamë se në Kosovë u ngritën vëllezërit tanë, të cilët për liri derdhin gjakun e tyre, vendosëm të veprojmë bashkë me ta: të fitojmë lirinë ose të vdesim"²⁶.

Karakterin gjithëpopullor të Kryengritjes e bëjnë bindës informacionet se në radhët e kryengritësve kishte luftëtarë prej moshës 15 vjeçare deri në moshë të thyer²⁷, dhe se në kryengritje ishin hedhur krah për krah shqiptarët myslimanë dhe shqiptarët katolikë të Vilajetit të Shkodrës dhe të Kosovës. Në një artikull të gazetës "Veçerna posta" thuhet se "të gjithë shqiptarët katolikë të rrethit të Prizrenit të aftë për të mbajtur armë, kanë braktisur shtëpitë dhe tash gjenden në mesin e kryengritësve"²⁸.

Në faqet e shtypit qendror bullgar krahas informacioneve mbi përleshjet midis kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë e xhandarmërisë osmane u jepet një vend me rëndësi kërkesave të shtruara të udhëheqjes së LKSH. Ato deri në fund të majit nuk jepen gjerësisht, si p.sh. kërkesat e njohura të Junikut, por përmbledhen me një fjalë-kërkesa autonomiste, shqiptarët dëshirojnë autonominë e Shqipërisë, e ndonjëherë përmendet statusi special i katër vilajeteve shqiptare. Në fund të majit, gazeta "Družba" njohton opinionin bullgar për këto kërkesa shqiptare: 1. Përcaktimi politik i kufijve të Shqipërisë; 2. Përdorimi i një flamuri kombëtar shqiptar; 3. Emrimi i një guvernatori të përgjithshëm, nga njëri prej pjesëtarëve të fiseve më të lashta shqiptare; 4. Përdorimi i gjuhës shqipe me shkronja latine si gjuhë zyrtare dhe 5. Largimi i të gjithë nëpunësve joshqiptarë dhe zëvendësimi i tyre me

²⁴ Vstanie v Albanija, Blgarija, 2.7.1912; Spoznaniya v Južna Albanija, Vardar, 1.8.1912, 1; Den, 15.8.1912,3.

²⁵ Drviš Hima prosledven, Preporec, 26.6.1912, 2. Polozenieto v Južna Albanija, 14.7.1912.

²⁶ Spazeniya v Južna Albanija, Vardar, 1.8.1912,1.

²⁷ Dviženiето v Albanija, Preporec, 8.5.1912, 1-2.

²⁸ Polozenivto v Albanija, Veçerna pošta, 20.7.1912; Albanskoto vstanie, Narodni prava, 13.6.1912,3.

shqiptarë²⁹. Më vonë, herë pas here jepen kërkesat shqiptare në tërësi apo në forma të përgjithësuar. kështu, p.sh. gazeta "Utro" i jep 11 kërkesat shqiptare, me anë të të cilave opinioni bullgar njihej më gjerësisht mbi programin e LKSH³⁰. Këtë e plotësojnë lajmet e mbajtjes së Kuvendit të Vlorës, ku morën pjesë përfaqësuesit e Shqipërisë së Jugut, i cili përkrahu kërkesat e Shqipërisë së Veriut me një Rezolutë të veçantë, në të cilën kërkohet që viset e banuara me shumicë prej shqiptarëve të shndërrohen në një krahinë të veçantë, me guvernator në vetë, futja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare³¹ etj. Është me interes të veçohet konstatimi i gazetës "Makedonija", sipas së cilës udhëheqësit shqiptarë, ndonëse *"kanë mospajtime në këkresat e tyre, ata në këto pika kanë gjuhë të përbashkët: emrimi i guvernatorit të përgjithshëm shqiptar, ushtarët shqiptarë të shërbejnë në Shqipëri, mësimi në shkolla të mbahet në gjuhën shqipe, të bëhet kompenzimi i dëmeve të luftës nga qeveria turke, përdorimi i të ardhurave për ndërtimin e Shqipërisë dhe drejta e mbajtjes së armëve"*³². Në fillim të gushtit jepet një publicitet i veçantë 14 kërkesave të Hasan Prishtinës, të cilat i boton çdo gazetë qendrore bullgare³³. Është me interes të veçohet një informacion, sipas të cilit kryengritësit shqiptarë të trevës së Selanikut solidarizoheshin me kërkesat e shqiptarëve të Shqipërisë së Veriut³⁴. Lexuesi bullgar njohtohet edhe për të gjitha memorandumet e udhëheqjes së LKSH që ia drejton Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha nëpërmjet konzujve të tyre në Shkup.³⁵

Karakter i gjithëpopullor i kryengritjes del me vetë faktin e përfshirjes së të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare. Lexuesi që e përcjell me kujdes kryengritjen, nuk e ka vështirë të vijë deri tek përfundimi se forcat kryengritëse në fillim përbëheshin kryesisht nga fshatarësia, më vonë në të u përfshinë edhe shtresat e qyteti, madje edhe ato më të lartat, siç ishin bejlerët, administratorët me ofiqe të larta, mydyrë dhe nëpunësit të tjerë të administratës, që vendosin t'i flakin këto poste dhe t'u bashkohen kryengritësve, të gatshëm të sakrifikonin edhe jetën për çështjen e çlirimit të atdheut.

Kjo dukuri mund të provohet me më tepër shembuj. Në një artikull të gazetës "Narodni prava" thuhet: *"Shqiptarët me influencë po i braktisin shtëpitë dhe po u bashkangjiteshin çetave kryengritëse"*³⁶. Këtë konstatim ajo e dëshmon me një artikull tjetër ku thuhet se sekretari i drejtorit të burgut të

²⁹ Družba, 28.V.1912, 1.

³⁰ Finala v Turcija, Utro, 3.7.1912, 1.

³¹ Dviženiete v Albanija, Preporec, 19.7.1912, 2.; Po kjo gazetë, 21.7.1912, 2.

³² Makedonija i Albanija, Makedonija, 12.8.1912, 2.

³³ Vardar, 1.8.1912; Albanskata revolucija, Preporec 10.8.1912, 3.

³⁴ Rebotničeski vestnik, 24.7.1912, 4.

³⁵ Memooara na Albancite, Utro, 20.6.1912; Albanskoto dviženie, Družba, 2.6.1912.

³⁶ Revolucija v Albanija, Narodni Prava, 10.V.1912, 3.

Shkupit Sadik Beu, gjakovar, iku në qytetin e lindjes, ku iu bashkua kryengritjes³⁷. Ndërkaq, gazeta "Utro" informonte lexuesit se "*Mydyri i Kojnares së Shkupit, Fehmi beu dhe ish redaktori i gazetës së turqve të rinj Adil Beu nga Kumanova, janë arratisur dhe tash gjenden në radhët e kryengritësve*³⁸". Gazeta "Druzha" bënte të ditur se bejlerët e Dibrës "*Kerim Cam Aga, Ismail Efendi Strazimiri, Hoxhë Sherifi, Arfi Aga, Ali bej Zaimi, dje janë arratisur dhe janë bashkuar me kryengritësit*³⁹". Kurse gazeta "Utro" lajmëronte se "*Ahmet beu nga Kumanova me 15 njerëzit e tij u është bashkuar kryengritësve shqiptarë*⁴⁰" dhe jepen shumë shembuj të tjerë.

Karakterit gjithëpopullor i kryengritjes bëhet edhe më bindës me shembujt e shumtë të dezertimit të xhandarëve dhe eprorëve nga radhët e xhandarmërisë osmane dhe kalimi i tyre në anën e kryengritësve. Po i veçojmë disa prej tyre: "*Kapiteni i xhandarmërisë së Mitrovicës Dërvish Beu, me çetën e tij i është bashkuar kryengritësve shqiptarë*⁴¹", "*të gjithë xhandarët e Bujanocit u janë bashkuar kryengritësve të tubuar në Tërnoc*⁴²", "(...) *me 13 të këtij muaji oficeri i xhandarmërisë Ali Beu me disa xhandarë të stacionuar në katundet lindore të Kumanovës janë arratisur dhe janë bashkuar me kryengritësit*⁴³", "*oficeri i xhandarmërisë së Kumanovës me disa xhandarë janë nisur për në Prishtinë për t'u bashkuar me kryengritësit*⁴⁴", "*40 xhandarët e Karakollit të Llapit kanë dezertuar dhe janë bashkuar me kryengritësit*⁴⁵", "*Nënkoloneli i xhandarmërisë së Shkupit me 16 qytetarë u është bashkuar kryengritësve*⁴⁶", "*komandanti i xhandarmërisë së Kumanovës Ali Efendiu bashkë me 500 shqiptarë u janë bashkuar kryengritësve*⁴⁷" etj.

Dimension të veçantë gjithëpopullor vlerësohet kryengritja që merr me fenomenin e dezertimit masovik të ushtarëve e oficerëve shqiptarë dhe kalimi i tyre në radhët e kryengritësve. Ky fenomen është i pranishëm që nga ditët e para të shpërthimit të kryengritjes, por me zgjerimin e saj, sidomos pas sukseseve të kryengritësve shqiptarë gjatë muajit qershor, ai merr përmasa të gjera. Shembuj të shumtë flasin mbi kalimin e ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë në anën e kryengritësve shqiptarë. Po japim disa shembuj: "(...) *një eskadron i kalorësisë me 4 oficerë nga Garnizoni i Prilepit iu bashkangjitën*

³⁷ Revolucija v Albanija, Narodni Prava, 7.6.1912, 1.

³⁸ Dviženieto v Albanija, Utro, 1.7.1912, 2.

³⁹ Družba, 1.7.1912, 2.

⁴⁰ Albanski pohod, Utro, 22.7.1912.

⁴¹ Dviženieto v Albanija, Preporec, 16.7.1912, 2.

⁴² Krizata v Turcija, Utro, 17.7.1912, 2.

⁴³ Albanski pohod, Utro, 22.7.1912.

⁴⁴ Krizata v Turcija, 23.7.1912, 2.

⁴⁵ Dezertirani džandari, Družba, 1.7.1912, 3.

⁴⁶ Izčetnati od Skopie, Družba, 1.7.1912, 3.

⁴⁷ Albanski četi vo kumanovsko, Preporec, 4.7.1912, 3.

kryengritësve (...) dy çeta ushtarësh nga Manastiri të armatosur u janë bashkuar kryengritësve⁴⁸", "Nga garnizoni i Rekës dhe i Ohrit kanë dezertuar disa ushtarë e oficerë⁴⁹", "(...) 39 ushtarë dhe 2 oficerë nga Dibra e Reka, me 40 mauzere e dy kuaj janë bashkuar me kryengritësit⁵⁰", "(...) më 9.7.1912 në afërsi të Elbasanit ushtarët e shenjtërisë kaluan në anën e kryengritësve⁵¹", "(...) 350 ushtarët dhe oficerët e dezertuar nga Manastiri gjenden me kryengritësit në malet në veri të Frashërit⁵²", "Bëhet e ditur nga Ministria e Punëve të Brendshme se nga Garnizoni i Manastirit dhe i Dibrës kanë dezertuar 1 kapiten, 9 togerë dhe 50 oficerë të tjerë dhe u janë bashkuar kryengritësve⁵³"; "(...) nga Durrësi kanë dezertuar një major, shumë oficerë dhe 20 ushtarë të cilët u janë bashkuar kryengritësve⁵⁴", "(...) 7 oficerë dhe 150 ushtarë nga Garnizoni i Tepelenës kanë kaluar në anën e kryengritësve⁵⁵", "(...) 50 myslimanë nga kombësia shqiptare që kanë ardhur në shërbim ushtarak në Shkup bashkë me armët e tyre u janë bashkuar kryengritësve⁵⁶", "(...) 4 oficerë dhe 187 ushtarë që kanë dezertuar nga Garnizoni i Selanikut dhe i Katerinës u janë bashkangjitur kryengritësve shqiptar⁵⁷", "(...) nënkoloneli Ali Efendi me disa shokë nga Garnizoni i Shkupit kanë dezertuar dhe janë bashkuar me kryengritësit në Malin e Thatë⁵⁸", "(...) nga Garnizoni i Tetovës kanë dezertuar 10 ushtarë dhe janë bashkuar me kryengritësit⁵⁹". Në lidhje me këtë dukuri gazeta "Utro" vinte në dukje se "Porta është e shqetësuar seriozisht për shkak të gjendjes në Shqipëri (...) dezertimit të madh të oficerëve dhe ushtarëve dhe bashkimi i tyre me kryengritësit⁶⁰". Ndërkaq gazeta "'Bulgarija" konstaton se "(...) rreth 12% të ushtarëve dhe oficerëve të Turqisë evropiane kanë dezertuar dhe janë bashkuar me kryengritësit⁶¹". Gazeta "Narodni prava", duke iu referuar burimeve zyrtare, theksonte se "prapa dezertimit të madh të oficerëve dhe ushtarëve shqiptarë qëndron një Komitet i fshehtë shqiptar me qendër në Manastir⁶²". Kurse, gazeta "Utro" konstatonte me të drejtë se "kryengritja

⁴⁸ Albanska revolucija, Narodni Prava, 12.6.1912, 3.

⁴⁹ Blgarija, 18.6.1912, 3.

⁵⁰ Družba, 1.7.1912, 2.

⁵¹ Po aty.

⁵² Utro, 15.7.1912.

⁵³ Narodni prava, 16.6.1912, 1.

⁵⁴ Albanskoto vstanie, Makedonija, 11.7.1912, 3.

⁵⁵ Dezertiranje v Janinsko, Družba, 1.7.1912, 3.

⁵⁶ Albancite v Skopje, Preporec, 6.8.1912, 3.

⁵⁷ Revolucija v Turcija, Narodni Prava, 26.6.1912, 3.

⁵⁸ Vojska na stana na vstanicite, Preporec, 13.7.1912, 1.

⁵⁹ Voeniot bunt vo Makedonija, Preporec, 22.6.1912, 4.

⁶⁰ Telegrami, Utro, 17.6.1912, 2.

⁶¹ Blgarija, 18.6.1912, 3.

⁶² Anarhija v Turcija, Narodni Prava, 16.6.1912, 1.

*shqiptare dhe rebelimi ushtarak (dezertimi (R.A) janë dy shtylla që po e fundosin qeverinë e turqve të rinjë*⁶³."

Shembujt e shumtë të shtypit qendror bullgar mbi masivizimin e kryengritjes dhe karakterin e saj gjithëpopullor, me përfshirjen në gjiun e saj të të gjitha shtresave dhe strukturave të shoqërisë shqiptare, që nga fshatarësia, shtresat e qytetit, bejlerët e agallarët dhe administratorët e lartë e deri te xhandarët e ushtarët me eprorët e tyre, e hedhin poshtë tezën e paqëndrueshme dhe qëllimkeqe të qarqeve shoviniste serbe, greke, ruse, po edhe ndonjë qendre tjetër evropiane se shqiptarët janë në shërbim të Turqisë, janë vegël e saj, se nuk kanë vetëdije dhe ideal kombëtar, prandaj edhe nuk duhet të meritojnë kurrfarë të drejtash. Kjo tezë hidhet poshtë edhe përmes deklaratave të vetë udhëheqësve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ku dalin qartë objektivat dhe synimet e saj. Kështu, një deklaratë e një udhëheqësi të Kryengritjes dhënë një gazete gjermane, të cilën e boton "Rabotničeski vestnik", ndër të tjera thuhet "(...) *ne shqiptarët s'kemi kurrfarë dashurie ndaj Turqisë. Serbët, grekët e bullgarët mund të mësojnë e shkruajnë në gjuhën e tyre, kurse neve shqiptarëve na është mohuar kjo e drejtë (...); dëshirojmë të na paraqesin para Evropës se jemi barbarë e të pakulturuar (...); ne do të përshëndesim e përqafojmë çdo kë që do të na ndihmojë të çlirohemi nga robëria. Poqëse edhe Japonia paraqitet si çliruesja e jonë, ne do t'i ishim mirënjohës, sepse kemi vetëm një dëshirë: të çlirohemi nga Turqia*⁶⁴". Karakterin dhe objektivat e mirëfillta të Kryengritjes së Përgjithshme para opinionit bullgar i bëjnë të qarta edhe intervistat e dy udhëheqësve të shquar të LKSH, Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës. Ismail Qemali në një intervistë të gjatë që i jep gazetës "Makedonija", ndër të tjera thekson: " (...) *bashkëmendimtarët e mij, pa dallim feje janë me mijëra, qofshin ata shqiptarë muhamedanë, katolikë apo ortodoks. Të gjithë janë të frymëzuar nga një qëllim i vetëm: Autonomia e Shqipërisë, qoftë edhe me çmimin e rrëkejve të gjakut*⁶⁵". Ndërsa, Hasan Prishtina pasi hedh poshtë pyetjen provokative të gazetarit se gjoja udhëheqja shqiptare ishte e përcarë, thekson se "*lufta që po bëjnë shqiptarët për autonominë e Shqipërisë, është etapa e parë drejtë pavarësisë së plotë, ku do të përfshihen veç 4 vilajetetve edhe pjesë të Vilajetit të Selanikut, ku shqiptarët përbëjnë shumicën*⁶⁶".

Lexuesi bullgar nga artikujt të shumtë mbi Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare, krahas përleshjeve, informohet edhe për raportin e forcave, rrjedhimisht numrin e kryengritësve shqiptarë, i cili rritet krahas zgjerimit dhe sukseseve të kryengritjes. Sipas pjesës dërmuese të shtypit bullgar numri i

⁶³ Padanieto na turskoto pravitelstvto, Utro, 8.7.1912, 2.

⁶⁴ Albanskoto vstanie i krizata v Turcija, Rabotničeski vsetnik, 14.7.1912, 2-3.

⁶⁵ Albanskoto vstanie, Makedonija, 26.V.1912.

⁶⁶ Izjajvljenija na Asan bej, Vardar, 25.7.1912.

kryengritësve në prill të vitit 1912 sillej rreth 12.000 veta. Prej tyre 3.000 veta ishin nën udhëheqjen e Basri Beut të Dibrës, 5000 nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës dhe 4000 nën udhëheqjen e Isa Boletinit⁶⁷. Ndërkaq, gjatë muajit maj-korrik numri i kryengritësve del se është rritur dukshëm. Sipas një informate të gazetës "Dnevnik" vetëm në pjesën Veriore të Vilajetit të Kosovës forcat kryengritëse të udhëhequra nga Hasan Prishtina e Bajram Curri në prak të çlirimit të Prishtinës numronin 15.000 luftëtarë⁶⁸, krahas 5.000 luftëtarëve të tjerë nën komandën e Isa Boletinit, që po marshonin prej Mitrovicës drejt Prishtinës⁶⁹. Në prak të çlirimit të Vilajetit të Shqipërisë Veriore numri i kryengritësve shqiptarë arrinte deri në 60.000 veta⁷⁰. Prej tyre 20.000 vepronin në Vilajetin e Kosovës, 20.000 në Vilajetin e Shkodrës dhe 20.000 të tjerë në Shqipërinë e Mesme⁷¹. Sipas gazetës "Makedonija" numri i kryengritësve shqiptarë që vepronin në Vilajetin e Kosovës ishte rreth 20.000 veta, kurse në mbarë Shqipërinë rreth 100.000 veta⁷². Numrin e kryengritësve prej 100.000 vetash e konfirmonte edhe gazeta "Blgarija"⁷³. Sipas deklaratës së deputetit të Vlorës në Parlament numri i të gjithë kryengritësve shqiptarë ishte rreth 80.000 veta⁷⁴. Sipas gazetës "Preporec", pas çlirimit të Prishtinës në këtë qytet ishin vendosur 30.000 kryengritës shqiptarë⁷⁵. Ndërkaq, sipas një artikulli të gazetës "Makedonija" numri i kryengritësve shqiptarë në Sanxhakun e Prishtinës ishte 20.000 veta, kurse në mbarë Shqipërinë 100.000 veta⁷⁶.

Krahas informacioneve mbi përleshjet dhe numrin e kryengritësve jepen të dhëna edhe për teknikën e armatimit të forcave ndërluftuese. Lexuesit i bëhet e qartë se armatimi i kryengritësve shqiptarë ishte pakrahasueshëm më i dobët kundrejt teknikës së përsosur të forcave të ushtrisë e xhandarmërisë osmane. Mirëpo, vihet në dukje se kryengritësit shqiptarë ia dalin të pajisen me një pjesë të teknikës së armatimit nga armiku pas sukseseve që korrnin mbi forcat e tij. Kështu, në një artikull të gazetës "Druzha" thuhet se një njësit turk duke kaluar Urën e Spiles afër Dibrës, u sulmua dhe u çarmatos nga kryengritësit shqiptarë me ç'rast ata siguruan një mitraloz, 1200 fishekë dhe dy siguresa mitralozash⁷⁷. Ndërkaq, sipas gazetës "Preporec", pjesa më e

⁶⁷ Preporec, 29.IV.1912.

⁶⁸ Albanskata revolucija, Dnevnik, 10.7.1912, 1.

⁶⁹ Albanskija pohod, silata na Boletinac, Utro, 17.1.1912, 2.

⁷⁰ Telegrami, Rabotničeski vestnik, 20.7.1912, 4.

⁷¹ Polozenie v Albanija, Makedonija, 11.7.1912; Rabotničeski vestnik, 16.7.1912, 4. Utro, 19.7.1912, 4.

⁷² Polozenie v Albanija, Makedonija, 11.7.1912.

⁷³ Blgarija, 16.7.1912, 2-3.

⁷⁴ Blgarija, 26.6.1912.

⁷⁵ Dviženieto v Albanija, Preporec, 12.7.1912, 3.

⁷⁶ Razbutovana Makedonija, Makedonija, 19.7.1912, 3.

⁷⁷ Družba, 1.7.1912, 2.

madhe e kryengritësve të Vilajetit të Kosovës në krye me Bajram Currin, Hasan Beun, që po i afrohen Prishtinës, përveç pushkëve janë të armatosur me 4 topa dhe 8 mitraloza⁷⁸. Po kjo gazetë një ditë më vonë konstaton se forcat kryengritëse në Shqipërinë Veriore veç pushkëve e mitralozëve dispononin edhe me 11 topa⁷⁹. Sipas gazetës "Rabotničeski vestnik", "shqiptarët pasi çliruan Prishtinën, u furnizuan me armë duke thyer depot e armëve⁸⁰". Ndërkaq, nga një përlëshje që u zhvillua në afërsi të Elbasanit në mes të kryengritësve shqiptarë dhe të forcave të ushtrisë dhe të xhandarmërisë turke, kryengritësit shqiptarë ia kanë dalë të shtijnë në dorë 4 topa, 322 mauzere dhe shumë kuaj⁸¹.

Nga mjaftë artikuj të shtypit qendror bullgar del qëndrimi i drejtë i kryengritësve shqiptarë ndaj ushtarëve të armikut të zënë robër. Në një artikull të gazetës "Narodni prava" më së miri demaskohet propaganda antishqiptare e shoviniste e turqve të rinj, njësojë sikurse edhe ajo serbe dhe greke, që përpiqeshin ta paraqisnin Lëvizjen Kombëtare Shqiptare si Lëvizje antikrishtere. *"Me qëllim të komprometimit të shqiptarëve që ta humbin simpatinë tek opinioni i krishterë evropian, njerëzit e qeverisë kanë përhapur lajme të rreme se gjoja ushtarët e robëruar të krishterë nga kryengritësit shqiptarë, pasi çarmatosen u pritët koka, kurse ushtarët mysliman lirohen. Kjo s'është e vërtetë, sepse shqiptarët nuk bëjnë dallime fetare. Të gjithë ushtarët e robëruar pa dallim feje, pasi çarmatosen lirohen⁸²"* Kjo ilustron edhe me një artikull tjetër në të cilin thuhet "(...) kryengritësit shqiptarë kanë robëruar në Malet e Rugovës 15 ushtarë dhe oficerë të cilët u dërguan pranë Shtabit të Hasan Prishtinës. Ai urdhëroi të çarmatoseshin vetëm ushtarët. Pasi bisedoi një kohë të gjatë me oficerët urdhëroi të përcillen deri në vend të sigurtë dhe të lirohen të gjithë (...)"⁸³.

Një specifikë e dimensionit gjithëpopullor të kryengritjes në faqet e shtypit bullgar vlerësohet ndihma gjithëpopullore dedikuar kryengritjes. Që nga përlëshjet e para të armatosura lexuesit i bëhet e ditur se kryengritësit kanë mbështetjen në popull, ndihmohen në forma të ndryshme, me anë të ushqimit sigurimit të fjetjes etj. Në një artikull të gazetës "Narodni prava" theksohet ndër të tjera, se shqiptarët e Gjakovës u dërguan 400 okë duhan kryengritësve afër Gjakovës⁸⁴, brenda një kohe të shkurtër banorët e Mitrovicës u dërguan kryengritësve shqiptarë në Prishtinë 1 vagon bukë. Të

⁷⁸ Dvizenieto v Albaniya, Preporec, 11.III.1912, 2.

⁷⁹ Dvizenieto v Albaniya, Preporec, 12.7.1912, 2.

⁸⁰ Telegrami, Rabotničeski vestnik, 16.7.1912, 4.

⁸¹ Vardar, 1.8.1912, 1.

⁸² Revolucija v Albaniya, Narodni Prava, 7.5.1912.

⁸³ Vstanie v Albaniya, Narodni Prava, 11.6.1912, 3.

⁸⁴ Revolucija v Albaniya, Narodni Prava,

gjitha furrat e Gjilanit, Kumanovës, Preshevës punojnë për kryengritësit⁸⁵; "bejlerët e Prishtinës kanë mbledhur 24000 lira turke për kryengritësit⁸⁶; kryengritësit shqiptarë që janë vendosur në shtëpitë e qytetarëve të njohur të Prishtinës kanë marrë 10.000 okë bukë që përgatitet nga qytetarët e Prishtinës⁸⁷, popullata myslimane shqiptare e Shkupit, sikurse edhe në qytetet e tjera po mbledh ndihma në të holla që destinohen për kryengritësit. Vetëm Menduh Beu i Shkupit ka dhënë për këtë qëllim 2000 lira turke⁸⁸, Mehmet pashë Deralla ndihmoi të mblidhen në anën e Tetovës 700 lira turke për kryengritësit⁸⁹ etj.

Si rezultat i përlëshjeve të gjata e të përgjakshme midis forcave kryengritëse shqiptare dhe ushtrisë e xhandarmërisë turke lexuesi bullgar vihet në dijeni se nga fundi i korrikut çlirohet pjesa më e madhe e Vilajetit të Kosovës dhe të Shkodrës. Gazeta "Makedonija" informon lexuesit se shqiptarët në shumë vise janë zotër të situatës⁹⁰, ndërkaq, gazeta "Vardar" bënte të ditur se Isa Boletini kishte marrë gjithë pushtetin në duar të tij në Tregun e Ri, Sjenicë dhe Plevle⁹¹. Ndërkaq gazeta "Preoprec" konstatonte se Sanxhaku i Prishtinës, Pejës dhe i Prizrenit është në duar të kryengritësve⁹². Prandaj, me të drejtë gazeta "Narodni prava" konstatonte se "Serbia që e trilloi emrin Stara Serbi (Kosovë, R.A) për qëllime politike, për të pasur mbështetjen e botës, këtë emër po e zhdukë flaka e zjarrit të kryengritësve shqiptarë⁹³".

Në fund, nga shumë artikuj të shtypit bullgar bëhet e ditur se si rezultat i mospërmbushjes së 14 kërkesave të kryengritësve shqiptarë të drejtuara në formë ultimatumit nga Ferizaj, pasoi marshimi i kryengritësve drejt Shkupit, kryeqytetit të vilajetit të Kosovës, të cilin e çliruan triumalisht më 12 gusht 1912⁹⁴, dhe pas vendosjes së pushtetit të tyre, ia dalin të çlirojnë qytetet e tjera të këtij Vilajeti, Preshevën, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, Velesin pastaj Strugën⁹⁵ etj. Ndonëse kryengritësit në krahinat dhe qytetet e çliuara vendosën një rend e disiplinë të mirëfilltë, ku ndëshkohej rreptësisht çdo shqiptarë që ngacmonte të paktën ndonjë nga pjestarët e minoritetit sllav, duke

⁸⁵ Preporec, 6.8.1912, 2.

⁸⁶ Dnevnik, 21.7.1912, 3.

⁸⁷ Dvizenieto v Albanija, Preporec, 11.7.1912, 2.

⁸⁸ Dvizenieto v Albanija, Makedonija, 16.7.1912, 1.

⁸⁹ Telegrami, Rabotničeski vestnik, 18.7.1912, 4.

⁹⁰ Turskiete reformi za Makedonija i Albanija, Makedonija, 17.6.1912, 3.

⁹¹ Vardar, 25.7.1912, 3.

⁹² Dvizanito v Albanija, Preporec, 16.7.1912, 2.

⁹³ Albanskata komisija, Preporec, 16.7.1912, 2.

⁹⁴ Albanski glavatari v Skopie, Preporec, 1.8.1912; Vstanite se se sobiraat v Skopie, utro, 5.8.1912, 3.

⁹⁵ Dnevnik, 9.8.1912, 3.

u sjellur e vepruar ndaj tyre në mënyrë dinjitoze⁹⁶. Shqiptarët e deridjeshëm trima, heroj të Revolucionit xhonturk, që meritonin rrespekt, fillojnë brenda ditës të trajtohen krejtësisht tjetërfare, si të rrezikshëm, të pakulturuar, madje edhe më të rrezikshëm se regjimi turk për minoritetin e krishterë sllav⁹⁷. Mjafton të merret shembull gazeta "Makedonija", që më parë i quante shqiptarët heroj të revolucionit xhonturk, trima syapatrembur që meritojnë çdo respekt⁹⁸, tani ishin shndërruar në egërsisë, pa kurrëfarë ideali kombëtar e kulturë njerëzore, por për të vetmen gjë që dinin ishte zullumi e dhuna mbi të krishterët sllav. Sipas saj, po edhe gjithë shtypit bullgar të kësaj kohe, prapa shqiptarëve të rrezikshëm tani qëndronte kryeministri austrohungarez Bertholdi: "(...) gjermanët projektojnë, turqit aprovojnë dhe Shkupi, Presheva, Kumanova, Velesi merren nga shqiptarët. Do t'i jepet autonomia Shqipërisë, ku do të përfshihen edhe Prilepi, Manastiri, Ohri, Kërçova, Lerini, Dibra, Tetova dhe Gostivari, sepse janë më në perëndim nga qytetet e përmendura, të pushtuara maqedone (...) një Krahinë Autonome me një shumicë nga shqiptarët e pakulturuar me tri besime të ndryshme, të cilët të vetmen gjë që e dijnë është zullumi dhe dhunë (...), kështu ngushtohen tokat bullgare⁹⁹".

Shtypi bullgar vazhdon të shpifë gjithçka kundër shqiptarëve edhe pas tërheqjes së tyre nga Shkupi dhe qytetet e tjera të çliruara prej tyre, sepse tashmë Aleanca ballkanike tashmë kishte përfunduar dhe po bëheshin përgatitjet e fundit për të sulmuar Turqinë evropiane, me devizën e proklamuar *Ballkani ballkanasve*, ku ushtria serbo-malazeze do t'i pushtojnë mbi gjysmën e trojeve etnike shqiptare, që po i mbajnë të okupuara sot e kësaj dite.

Të përfundojmë: shtypi bullgar i kushtoi një vëmendje të veçantë Kryengritjes së Përgjithshme Antiosmane të vitit 1912, për aq sa lejoi strategjia e politikës afatgjate bullgare kundër trojeve shqiptare. Kishte qëndrim të drejtë derisa nuk u rrezikua objektivi i parë i saj. Pas çlirimit të viseve shqiptare të pretenduara me projektin e Shën Stefanit, filloi etapa tjetër e shkrimit të shtypit bullgar, krejtësisht ndryshe nga e para, kur kryengritja shqiptare dhe shqiptarët paraqiteshin pa kurrëfarë ideali, të pakulturuar, që nuk meritojnë lirinë, dhunues e terrorizues të minoritetit të krishterë, vetëm pse kishin çliruar trojet e Shqipërisë etnike të banuara ndër shekuj me shumicë prej shqiptarëve.

⁹⁶ Albancite v Skopje, Preporec, 68.1912, 3.

⁹⁷ Cuzdija pecat, makedonija, 26.8.1912, 1.

⁹⁸ Makedonija, Albancite vstavaat, 15.IV.1912, 2.

⁹⁹ Makedonija, kryeartikulli redakcional, 12.8.1912.

Ramiz Avdyli

THE BULGARIAN PRESS ABOUT THE ALBANIAN GENERAL UPRISING OF THE YEAR 1912

Summary

The greater part of the Bulgarian press, being under influence of the official policy which was pretending a Bulgaria of San Stefano in which were also included parts of the Albanian ethnic trunk east to the Lake of Ohër, the river Drini, mountain Sharr and the Karadak Massive (Mountain), took a double position towards the Albanian uprising, and consequently towards the Albanian question. While the Albanian territories in the east of this line, on the one hand, were always mentioned as the Bulgarian territories, the other territories of Albania, inhabited by the Albanians-the most ancient people of the Balkans. In this aspect the Albanian general uprising, until the liberation of Shkup and other Albanian territories of today's Macedonia, (it) was treated quite objectively, evaluating it rightly as a general (total) uprising of an authentic national character as a nations of the Balkans did. Meanwhile, spreading of the uprising in the was Bulgarian pretending territories too, by the Albanian rebels (fighters) was considered as e harsh attack on the Bulgarian territorial integrally, more difficult than under the Ottoman reign (regime), while the Albanians instantly were presented as wild, non-cultivated or non-cultural, who were backed up by Austro-Hungary, judgments which were scientifically inconstant, tendencious and chauvinistic, because the Albanians only had liberated the territories inhabited for centures with the overwhelming majority of theirs i.e. the real Albanian that was occupied unjustly during the First Balkan War, and even today more than half of the territories of Albanian are being kept under occupation from Serbia, Montenegro and Macedonia.